



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:200948

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05441877

P.nr.438/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit Z. P. nga fsh. S.K.Lipjan, të cilin e mbronë Kimete Sahiti av. në Lipjani, e të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.4983/23 të dt.06.09.2023, për shkak të veprës penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 paragrafin 1 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar, publik, të mbajtur me datën 06.03.2024, në prani të prokurores së shtetit Nebahate Salihu, të pandehurit dhe mbrojtëses së tij, në po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

Z.P., i lindur me ..., në fshatin S., K. L., ku edhe jeton, i biri i R. dhe Sh., e gjinisë B., i martuar, me gjendje së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, veteran i luftës në Kosovë, me nr. personal ..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me dat;n 02.08.2023, në shtëpinë e tij, e cila gjendet në fshatin S., K. L., i pandehuri Z. P. ka përdorë armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, në atë mënyrë që në një ndej të organizuar me rastin e fejesës së djalit të tij në shenjë gëzimi ka shtënë 4 herë me arma e zjarrit e llojit pushk gjyeteie e tipit ... me nr. serik ..., -

-me këtë ka kryer veprën penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartëcekura si dhe dispozitave të neneve 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 39, 42, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 71 par.1 nënpar.3 të KPRK-së dhe neni 367 par. 1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 2 (dy) vite nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundertën konform nenin 50 të KPRK-së dënimi me kusht do të revokohet.

DETYROHET i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale kësaj gjykate t'ia paguajnë paushallit gjyqësor shumën prej 50-€, si dhe shumën nga 20-€, në Fondin e

Mbrojtjes së Viktimave, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.4983/23 të dt.06.09.2023, e ka akuzuar të pandehurin Z. P. nga fsh. S. K.L., për shkak të veprës penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 paragrafin 1 të KPRK-së.

Prokurorja e shteti në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajsisë nga ana e të pandehurit pasi që janë plotësuar kushtet nga neni 242 të KPPK për pranimin e fajsisë dhe vetë pranimi i fajsisë është në mbështetje të plotë me të gjitha shkresat e lëndës që përmban aktakuza, duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajsisë dhe të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit si dhe i ka propozuar gjykatës që me rastin e matjes së dënimit ti mer parasysh rrethanat lehtësuese siq është pranimi i fajsisë.

I pandehuri Z. P. në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajsin për veprën penale për të cilën akuzohet dhe njëherit ka shtuar se armën e ka me leje për mbajtje dhe ditën kritike e ka fejuar djalin dhe sipas zakoneve tona kur ipet dora zakonisht është e shtëna me armë si shej e traditës dhe armën e ka pasur me leje dhe ka menduar se nuk është e ndalushme, ka kërkuar falje nëse është dashtur të ketë leje të veqant për qitje se sikur ta kisha ditur do të kisha kërkuar leje dhe e ka lutur gjykatën që ti ketë parasysh këto rrethana sepse është njeri familjar, kujdeset për familje dhe asnjëherë nuk ka pasur të keqe me askënd.

Mbrojtësja e të pandehurit av. Kimete Sahiti në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se ashtu siç është deklaruar i mbrojturi se armën e ka përdor për shkak të ahengut familjar që ka pasur me rastin e fejesës së djalit të tij e për këtë ka kërkuar falje sepse për momentin nuk ka qenë në dijeni që ka bërë diqka të kundërligjshme. I kërkon falje gjykatës për një veprim të till, duke e lutur gjykatën që ta ketë parasysh si rrethana lehtësuese që nuk ka asnjë vepër penale dhe është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjit dhe se një veprim të till nuk do ta përsëris më. Duke i propozuar gjykatës që me lejen që e ka nga organi kompetent për posedimin e armës mundësisht arma ti kthehet dhe të mos asgjësohet pa nevoj sepse është e re dhe është anëtar i Shoqatës së Gjuetarëve "Sokoli" në Lipjan.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësen e tij, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk është e përfshirë në shkelje të qarta ligjore e as gabime faktike, konform nenit 242 të KPPK-së, e pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes së veprës penale, pra faktin se i njëjti për herë të parë ka rënd ndesh me ligjin, sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurin pra faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e ulët të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, pra faktin se i njëjti ka pasur leje për armën e gjuetisë me afat nga viti 2023 deri në vitin 2028 dhe është anëtar i shoqatës së gjuetarve "S." në Lipjan, dhe se për fejesën e djalit të tij ka shtënë me armë duke mos qenë i vetëdijshëm se është e ndaluar mirëpo përkundër kësaj i njëjti askën nuk e ka rrezikuar apo kërcënuar andaj të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht konform nenit 47 të KPRK-së. Pra gjykata i shqiptoi dënim me kusht edhe për veprën penale që parashihet dënime

mbi 5 vite burgim ngase në rastin konkret janë zbatuar dispozitat e zbutjes së dënimit konform nenit 70 të KPRK-së duke marrur parasysh rrethanat veçanërisht lehtësuse pra faktin se i pandehuri është familjar, i moshës së pjekur, asnjëherë i dënuar, ka bashkëpunuar me organet e drejtësisë, pranimi i fajit, keqardhja si dhe rrethanat që u përmenden më lartë pra motivi i cili ka ekzistuar tek i njëjti me rastin e fejesës së djalit ka shtënë me të njëjtën armë si shenje e traditave të popullit tonë pa e dëmtuar apo rrezikuar ndokënd, andaj të gjitha këto rrethana gjykata i zbatoj me rastin e zbutjes së dënimit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 449 dhe 450 të KPPK-së, ku shuma në emër të paushallit gjyqësor prej 50 euro u caktua në bazë të ndërlikshmërisë së rastit, ndërsa shuma prej 20 €, u bazua në nenin 36 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimin.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN

P.nr.438/23 dt.06.03.2024

Bashkëpunëtorja profesionale

Gentiana Dakaj

GJYQTARI

Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 30 ditë nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2023:200948
Datë: 12.03.2024
Numri i dokumentit: 05441877